

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar
Financial Reporting

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 26.09.2020

1. Me 1 janar 2019, Titan sh.a. bleu 4 milion të aksioneve të zakonshme të Rhea sh.a-së, duke paguar €4.50 për secilën. Në datën e blerjes, fitimet e mbajtura të Rhea sh.a ishin €8.4 milion.

Më poshtë janë paraqitur draft pasqyrat e pozitës financiare të këtyre dy kompanive me 31 dhjetor 2019:

	Titan sh.a.	Rhea sh.a
	€000	€000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Toka dhe ndërtesat	22,500	12,000
Fabrika dhe paisjet	20,450	10,220
Investimet në Rhea sh.a	<u>18,000</u>	<u>-</u>
<i>Total pasuritë jo-qarkulluese</i>	60,950	22,220
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	9,850	6,590
Të arkëtueshmet tregtare	11,420	3,830
Paraja	<u>490</u>	<u>-</u>
Total pasuritë	82,710	32,640
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	10,000	5,000
Fitimet e mbajtura	51,840	11,700
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
10% obligacione 2022	12,000	6,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	6,400	7,390
Mbitërheqja bankare	-	570
Tatimi	<u>2,470</u>	<u>1,980</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	82,710	32,640

Ekstraketet nga pasqyra e fitimit ose humbjes të Rhea sh.a-së, para korigjimeve ndër-grupore për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 janë:

	€'000
Fitimi para tatimit	5,400
Shpenzimet e tatimit	<u>1,600</u>
	3,800

Informatat në vijim janë të rëndësishme.

- i) Te tokat dhe ndërtesat e Rhea sh.a-së është përfshirë një hapësirë e madhe e tokës me një kosto prej €5 milion. Vlera e drejtë e saj në datën e blerjes së aksioneve të zakonshme në Rhea sh.a ishte €7 milion dhe deri me 31 dhjetor 2019 është rritur në €8.5 milion. Është politikë e grupit që toka duhet të bartet sipas vlerës së drejtë dhe të mos zhvlerësohet.
- ii) Gjithashtu në datën e blerjes së Rhea sh.a, në fabrikën dhe paisjet e Rhea sh.a-së ishte përfshirë një fabrikë që kishte vlerë të drejtë prej €4 milion mbi vlerën e saj bartëse. Kjo fabrikë kishte jetë të mbetur prej 5 viteve. Zhvlerësimi është në baza drejtvizore. Pasuritë tjera të Rhea sh.a-së kishin vlerë të drejtë të njejtë me vlerën bartëse.

- iii) Gjatë vitit Rhea sh.a shiti mallra te Titan sh.a. për €1.8 milion. Rhea sh.a e shton një marzhë prej 20% mbi kosto për të gjitha shitjet e saj. Mallrat më çmim të shitjes prej €0.45 milion ishin të përfshira në stoqet e Titan sh.a. me 31 dhjetor 2019.
- iv) Një test i dëmtimit është kryer me 31 dhjetor 2019 dhe tregoi se zëri i mirë është dëmtuar për €1.5 milion.
- v) Në të pagueshmet tregtare të Rhea sh.a është përfshirë një shumë prej 0.5 milion që e kishte ndaj Titan sh.a. E njejta shumë ishte e përfshirë edhe në të arkëtueshmet tregtare të Titan sh.a.
- vi) Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së plotë (të drejtë). Vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes ishte €5 milion.

Kërkohet:

- a) **Përgatite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Titan sh.a. me 31 dhjetor 2019.** (17 pikë)
- b) **Shpjego shkurtimisht shpalosjet e kërkuara nga SNRF 3 *Kombinimet biznesore*** (3 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

Grupi Titan sh.a Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019

	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Zëri i mirë	2,100
Toka dhe ndërtesat (22,500+12,000+2,000+1,500)	38,000
Fabrika dhe paisjet (20,450+10,220+4,000-800 zhvl)	<u>33,870</u>
	73,970
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet (9,850+6,590-75 L13)	16,365
Të arkëtueshmet tregtare (11,450+3,830-500)	14,750
Paraja	<u>490</u>
	105,575
<i>Ekuiteti</i>	
Aksionet e zakonshme	10,000
Rivlerësimi (pjesa e përfitimit pas blerjes që i takon grupit 1.5 m x 0.8)	1,200
Fitimet e mbajtura	<u>52,580</u>
	63,780
Interesi jo-kontrollues	5,485
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
10% obligacione 2022 (12,000 + 6,000)	18,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Të pagueshmet tregtare (6,400 + 7,390-500)	13,290
Mbitërheqja bankare	570
Tatimi (2,470 + 1,980)	<u>4,450</u>
	105,575

Llogaritjet

1. Struktura e grupit

Titan sh.a

$(4m/5m \times 100) = 80\%$

Data e blerjes/kontrollit: 1 janar 2019

20% IJK

Periudha pas blerjes: 1 vit

2. Zëri i mirë

	€'000
Kosto e investimi	18,000
IJK	5,000
Minus:	
Neto pasuritë në blerje L12 (19,400 x80%)	<u>(19,400)</u>
Zëri i mirë në blerje	3,600
Minus humbja nga dëmtimi	<u>(1,500)</u>
Zëri i mirë në konsolidim	2,100

3. Fitimi i perealizuar

€0.45 milion x 0.2/1.2 = €0.75 milion

4. Fitimet e mbajtura	Titan sh.a.	Rhea sh.a
Sipas pyetjes	51,840	11,700
Para blerjes		<u>(8,400)</u>
		3,300
Zhvlerësimi shtesë		(800)
FPR		<u>(75)</u>
		2,425
Pjesa që i takon grupit (2,425 x 0.8)	1,940	
Dëmtimi i ZM (1,500 x 80%)	<u>(1,200)</u>	
	52,580	
5. IJK	€'000	
IJK në datën e blerjes	5,000	
Pjesa e fitimeve pas blerjes	485	
Dëmtimi i ZM (1,500 x 20%)	(300)	
Pjesa e rivleresimit pas blerjes (1,500 x 20%)	<u>300</u>	
IJK në fund	5,485	

b)

SNRF 3 kërkon shpalesje të gjëra. Kjo përfshin harmonizimin e shumës bartëse të zërit të mirë në fillim dhe në fund të periudhës, duke paraqitur ndaras:

- Shumën bruto të humbjeve të akumuluar nga dëmtimi në fillim të periudhës
- Zërin e mirë shtesë të njohur gjatë periudhës
- Humbjet e dëmtimit të njohura gjatë periudhës
- Diferencën neto të shkëmbimit të paraqitur gjatë periudhës, dhe
- Shumën bruto dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi në fund të periudhës

2.

a) Në vijim janë paraqitur të dhënat e Mimas sh.a, një kompani e listuar në bursë.

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017

Aksionet e zakonshme (vlera nominale 25 cent)	€10 milion
Fitimi i vitit 2017 i atribuar aksionarëve të zakonshëm	€10 milion

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018

1 prill 2018

- emetim i 8 milion aksioneve të zakonshme me çmim të tregut

1 tetor 2018

- emetim bonus i 1 aksioni për çdo 4 aksione të mbajtura

Fitimi i vitit 2018 i atribuar aksionarëve të zakonshëm	€13.8 milion
---	--------------

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019

1 korrik 2019

- Emetim i të drejtave prej 2 aksione të reja me çmim €1 për çdo 5 aksione të mbajtura. Çmimi i tregut pak para emetimit ishte €2.4 për aksion

Fitimi i vitit 2019 i atribuar aksionarëve të zakonshëm	€19.5 milion.
---	---------------

Kërkohe:

Llogarite fitimin për aksion themelor për vitet që përfundojnë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2019 duke përfshirë informatat krahasuese (pra edhe vitin 2017 për 31 dhjetor 2018 e edhe vitin 2018 për 31 dhjetor 2019). (8 pikë)

b) Me 1 janar 2019 Tethys sh.a emetoi €20 milion obligacione të konvertueshme me normë prej 8%. Obligacioni u emetua në vlerë nominale. Kushtet e konvertimit ishin që me 1 janar 2021 për çdo €100 të obligacionit do të emetohen 50 aksione të zakonshme në opcion të mbajtësit të obligacionit. Në të kundërt obligacioni do të ripaguhet në para në shumën nominale.

Gjithashtu me 1 janar 2019 drejtorët e Tethys sh.a u shpërblyen me opione të aksioneve për 12 milion aksione të zakonshme të ushtrueshme me 1 janar 2021 me çmim prej €1.50 për aksion. Çmimi mesatar i tregut të aksioneve të Tethys sh.a gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2019 ishte €2.50 për aksion.

Norma e tatimit në fitim ishte 25%. Fitimet e atribueshme tek aksionarët e zakonshëm për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 ishin €25,200,000 ndërsa numri mesatar i ponderuar i aksioneve të gjatë vitit 2019 ishte 100 milion. Opcionet e aksioneve dhe interesi në obligacione janë regjistruar saktë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe nuk duhet bërë ndonjë korigjim.

Kërkohet:

Llogarite FPA-në e thjeshtë dhe të dobësuar të Tethys sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 (shifrat krahasuese nuk kërkohen).

Ju duhet të supozoni që edhe borxhi i konvertueshëm e edhe opcionet e aksioneve janë dobësuese. (6 pikë)

c) Iapetus sh.a emetoi 3,000 obligacione të konvertueshme sipas vlerës nominale. Obligacionet janë të ripagueshme pas 4 viteve në vlerën e tyre nominale prej €1,000 për obligacion. Obligacioni paguan interes në fund të vitit prej 4% në vlerë nominale. Secili obligacion mund të konvertohet në datën e maturimit në 5 aksione të zkonshme. Norma e interesit që mbizotëronte në treg për obligacionet e njejta por pa të drejtë të konvertimit ishte 6%.

Faktorët e skontimit për €1 janë si në vijim:

	4%	6%
Viti 1	0.9615	0.9434
Viti 2	0.9246	0.8900
Viti 3	0.8890	0.8396
Viti 4	0.8548	0.7921

Kërkohet:

Cila është vlera e komponentës së ekuitetit në obligacion? (6 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

a

Mimas sh.a

FPA themelore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018:

Emetimi me 1 prill 2018 sipas vlerës së tregut duhet të ponderohet:

	$40m \times 12/12 = 40m$
Aksionet e reja 8m	$\frac{8m \times 9}{12} = \underline{6m}$
	48m 46m

Pa emetimi bonus kjo do të jipte një FPA prej 30 cent (13.8m/46m x 100).

Emetimi bonus prej 1 për 4 do të rezultoj me 12 milion aksione të reja që japin një numër total prej 60 milion aksione të zakonshme.

Emetimi bous do të zvogëloj FPA në **24 cent** (30 cent x 48m/60m).

Informata krahasuese e FPA-së për vitin 2017 do të riparaqitet si **20 cent** (25 cent x 48m/60m).

FPA themelore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019:

Emetimi i të drejtave të 2 aksioneve për çdo 5 është bërë në gjysmë të vitit me 1 korrik 2019.

Çmimi teorik pa të drejtat mund të llogaritet si:

100 aksione x €2.40 =	€240
40 aksione të reja për €1 secila=	€40
140 aksione teoritikisht kanë vleren (€280/140 aksione) = €2 secila	

Ponderimi:

$60m \times 6/12 \times 2.40/2.00 =$	36 milion
Emetimi i të drejtave (2 për 5) +24m =84m x 6/12 =	<u>42 milion</u>
Totali i ri mesatarja e ponderuar	78 milion

FPA është pra 25 cent (€19.5m/78m x 100).

Shifra krahasuese (për 2018) do të riparaqitet në 20 cent (24 cent x 2.00/2.40).

(ii) FPA bazike për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 është 30 cent (€25.2m/84m x 100).

Dobësimi

Obligacioni i konvertueshëm

Kur obligacioni të konvertohet €1.2 milion pas tatimit do të kursehen (€20 milion x 8% x (100% - 25%)) dhe 10 milion aksione të reja do të emetohen (€20m/€100 x 50).

Opcionet e aksioneve

Opcionet për 12 milion aksione për €1.50 secila do të sjellin arkëtime prej €18 milion. Kjo shumë do të mund të blinte 7.2 milion aksione me çmim mesatar të tregut prej €2.50 për aksion (€18m/€2.50). Numri i aksioneve shtesë është 4.8 milion aksione (12m - 7.2m).

Duke përdorur shifrat e mësipërme FPA e dobësuar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 është 23 cent (€25.2m + €1.2m)/ (100m + 10m + 4.8m)).

c)

		€
Kryegjëja		
€3,000,000 të skontuar më 6% për 4 vite:		
€3,000,000 x 0.7921		2,376,300
Interesi		
Viti 1 120,000 x 0.9434	113,208	
Viti 2 120,000 x 0.8900	106,800	
Viti 3 120,000 x 0.8396	100,752	
Viti 3 120,000 x 0.7921	<u>95,020</u>	
		<u>415,812</u>
Vlera e komponentës së detyrimit		2,792,112
Komponenta e ekuitetit (shifër balancuese)		<u>207,888</u>
Të ardhurat nga emetimi i obligacionit		<u>3,000,000</u>

3.

a) Ju jeni drejtor financiar i Umbriel sh.a. Umbriel sh.a është duke përgatitur pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019.

Umbriel sh.a bleu tërë kapitalin aksionar të Oberon sh.a gjatë vitit. Blerja ishte bërë nepërmjet këmbimit të aksioneve. Kushtet e këmbimit ishin bërë duke u bazuar në vlerat relative të të dy kompanive duke i kapitalizuar rrjedhat e pritura të parasë të të dy kompanive. Kur vlerat e drejta të pasurive neto të identifikueshme të Oberon sh.a-së u zbriten nga vlera e kompanisë, zëri i mirë i saj u llogarit në €2.5 milion. Një llogaritje e njejtë e vlerësoi zërin e mirë të Umbriel sh.a në €4 milion. Bordi i drejtorëve dëshiron të përfshijë të dy vlerat e zërit të mirë në pasqyrat financiare të konsoliduara.

Kërkohet:

Shpjego se si Umbriel sh.a duhet ta trajtoj zërin e mirë në pasqyrat e konsoliduara financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 duke komentuar pikëpamjet e bordit të drejtorëve . (6 pikë)

b) Ju jani një kontabilist i çertifikuar rishtazi dhe ju është kërkuar që shkurtimisht të prezantoni për stafin e ri të departamentit të financave lidhur me procesin e vendosjes së standardeve nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të kontabilitetit (BSNK/IASB).

Kërkohet:

Shpjego shkurtimisht procesin e vendosjes së standardeve të aplikuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të kontabilitetit (BSNK/IASB). (5 pikë)

c) Sipas SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kursin e këmbimit* valuta funksionale është valuta me të cilën operon mjedisi ekonomik primar në të cilin zhvillon veprimtarinë e vet entiteti.

Kërkohet:

Identifiko TRE faktorë në pajtim më SNK 21 që një entitet duhet të i marrë parasysh gjatë përcaktimit të valutës funksionale. (3 pikë)

d) Një entitet, valuta funksionale e të cilit është euro, me 31 tetor 2019 ka blerë një makinëri nga jashtë për 8 milion dollar amerikan me afat pagese 6 muaj. Me 31 tetor 2019 kur kursi i këmbimit ishte 1.2 dollar = 1 euro. Në fund të vitit me 31 dhjetor 2019, shuma ende nuk është paguar dhe kursi i këmbimit në këtë datë ishte 1.25 dollar = 1 euro.

Kërkohet:

Trego shumat që duhet të paraqiten në pasqyrat financiare të zërave në vijim:

- **Koston e paisjes në datën e blerjes me 31 tetor 2019**
- **Fitimim ose humbjen nga këmbimi valutor**
- **Të pagueshmët tregtare me 31 dhjetor 2019.** (6 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

a)

Përderisa është e pranueshme të vlerësohet zëri i mirë në shumë prej €2.5 milion për degën Oberon sh.a duke u bazuar në informatat e dhëna dhe të përfshihet në pasqyrën e e konsoliduar të pozitës financiare, trajtimi i njëjtë nuk mund të bëhet për zërin e mirë të vet Umbriel sh.a-së. Llogaritja mundet që me të vërtetë të jetë reale prej €4 milion për zërin e mirë të Umbriel sh.a-së, dhe nuk ka ndonjë dallim në natyrën e zërit të mirë, por duhet kuptuar që zëri i mirë i Umbriel sh.a-së është zëri i mirë i brendshëm dhe SNRF ndalon që ky zëri të paraqitet në pasqyrat financiare. Arsyeja kryesore është matja e besueshme. Vlera e zërit të mirë të blerë mund të dokumentohet por kjo metodë nuk është e vlefshme si bazë për njohjen e zërit të mirë të gjeneruar së brendshmi.

b)

Agjenda e përgjithshme e IASB fillimisht do të vendoset nga diskutimet me Këshillin për Konsultime të Standardeve. Procesi për zhvillim të standardit individual do të mund të përfshijë hapat në vijim.

- Hapi 1 Gjatë fazave të hershme të projektit, IASB mund të themelojë një Komision Këshilldhënës i cili do të ofronte këshilla për çështjet që paraqiten gjatë projektit. Konsultimi me Komisionin Këshilldhënës dhe Këshillin për Konsultime të Standardeve paraqitet gjatë tërë projektit.
- Hapi 2 IASB mund të zhvillojë dhe të publikojë Dokumentet e Diskutimeve për komente publike.
- Hapi 3 Pas pranimit dhe shqyrtimit të komenteve, IASB do të zhvillonte dhe publikonte një Përmbledhje për komente të publikut.
- Hapi 4 Pas pranimit dhe shqyrtimit të komenteve, IASB do të lëshonte përfundimisht Standardin Ndërkombëtar për Raportim Financiar.

Periodha e ekspozimit për komente të publikut zakonisht zgjat 90 ditë. Megjithatë, në rrethana të veçanta, mund të lëshohen propozime me periudhë 60 ditore për komente. Përmbledhja e Interpretimeve të IFRIC-ut paraqiten për komente në një periudhë prej 60 ditësh

c) SNK 21 parashtrohet se një entitet duhet të mbajë parasysh faktorët e mëposhtëm për të përcaktuar valutën e vet funksionale:

- (a) Valuta e cila influencon kryesisht çmimet e shitjes të mallrave dhe shërbimeve (dhe kjo është shpesh valuta në të cilën citohen dhe paguhen çmimet e shitjes për mallra dhe shërbime)
- (b) Valuta e vendit në të cilin konkurrenca dhe rregulloret përcaktojnë kryesisht çmimet e shitjes të mallrave dhe shërbimeve
- (c) Valuta e cila influencon kryesisht kostot e punës, materialeve dhe kostot e tjera për dhënien e mallrave ose ofrimin e shërbimeve (kjo është shpesh valuta në të cilën citohen dhe paguhen këto kosto)

d)

- Kostoja e fabrikës €6.67 milion,
- Fitim nga kursi i këmbimit €0.27 milion,
- Të pagueshmet tregtare €6.4. milion

4. Në vijim janë paraqitur pasqyrat financiare të Enceladus sh.a:

Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor

	2019	2018
	€'000	€'000
Të hyrat	11,480	10,000
Kosto e shitjes	<u>(9,680)</u>	<u>(8,000)</u>
Fitimi bruto	1,800	2,000
Përfitimi nga rivlerësimi i pronës investuese	120	-
Kosto e shperndarjes	(240)	(200)
Shpenzimet administrative	(700)	(600)
Kosto financiare	<u>(100)</u>	<u>(50)</u>
Fitimi para tatimit	880	1,150
Shpenzimet e tatimit	<u>(320)</u>	<u>(400)</u>
Fitimi për vitin	560	75

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor

	2019	2018
	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	5,680	3,720
Prona investuese	<u>920</u>	<u>800</u>
	6,600	4,520
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	2,440	1,620
Të arkëtueshmet tregtare	960	1,080
Paraja	<u>-</u>	<u>100</u>
	<u>3,400</u>	<u>2,800</u>
Total pasuritë	10,000	7,320
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme	3,000	1,200
Premia e aksioneve	200	-
Teprica e rivlerësimit	300	100
Fitimet e mbajtura	<u>2,880</u>	<u>2,620</u>
	6,380	3,920
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Notë krediti	-	800
Detyrim i tatimit të shtyrë	<u>100</u>	<u>60</u>
	100	860
<i>Detyrimet afatskurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	2,400	2,240
Mbitërheqja bankare	420	-
Provizionet për garancion	400	200
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>300</u>	<u>100</u>
	<u>3,520</u>	<u>2,540</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	10,000	7,320

Informatat financiare në vijim janë të rëndësishme:

- i) Një zë i fabrikës me vlerë bartëse prej €480,000 i shit me një humbje prej €180,000 gjatë vitit. Kjo humbje është përfshirë në shpenzimet administrative.
- ii) Zhvlerësimi në shumë prej €560,000 është ngarkuar (tek kosto e shitjes) për pronën, fabrikën dhe paisjen gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2019. Enceladus sh.a përdor modelin e vlerës së drejtë në SNK 40 *Prona investuese*. Nuk ka pasur blerje apo shitje të pronës investuese gjatë vitit.
- iii) Nota e kreditit është ripaguar para kohës së maturimit, dhe kjo shkaktoi një ndëshkim prej €40,000 që është përfshirë në shpenzimet administrative në pasqyrën e fitimit ose humbjes.
- iv) Ka pasur një emetim të aksioneve të reja për para me 1 korrik 2019. Nuk ka pasur emetim bonus të aksioneve gjatë vitit.
- v) Enceladus sh.a jep 12 muaj garancion për produktete e saj. Shumat e treguara në detyrimet afatshkurtëra si provizion për garancion janë një vlerësim i drejtë i kërkesavë që pritet të bëhen lidhur me garancionet. Kostot e garancioneve janë përfshirë në kosto te shitjeve .
- vi) E vetmja lëvizje në fitimet e mbajtura përgjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2019 është për shkak të fitimit të vitit dhe pagesës së dividendës.

Gjatë diskutimeve preliminare për pasqyrat financiare, nje nga anëtarët e bordit shprehu pakënaqësinë për pozitën e parasë së gatshme. Ai nuk mund të kuptonte se si përkundër fitimit prej €560,000, pozita e parasë së gatshme është përkeqësuar nga një saldo pozitive prej €100,000 në dhjetor 2018 në një deficit prej €420,000 në dhjetor 2019. Ai ka dyshime se drejtori financiar mund të ketë keqpërdorur paranë.

Kërkohet:

Përgatite pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme për Enceladus sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 në pajtim me SNK 7 *Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme* për të shpjeguar situatën që po e brengos drejtorin. (20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

Enceladus sh.a

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vtin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

	€'000
<i>Aktivitetet operative</i>	
Fitimi para tatimit	880
Korigjimet:	
Kosto financiare	100
Zhvlerësimi	560
Humbja nga shitja e PFP	180
Kamata ndëshkuese në pagimin e kredisë	40
Përfitimi nga rivlerësimi i pronës investuese	(120)
Rritja në provizionet për garancion	200
<i>Levizjet në kapitalin qarkullues:</i>	
Rritja në stoqe	(820)
Zvogëlimi në të arkëtueshmet tregtare	120
Rritja në të pagueshmet tregtare	160
<i>Rrjedhat e parasë nga operacionet para fitimit para interesit dhe tatimit</i>	
Kosto financiare	(100)
Tatimi i paguar	<u>(80)</u>
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	1,120
 <i>Aktivitetet investuese</i>	
Blerja e PFP	(2,800)
Shitja e PFP	<u>300</u>
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese	(2,500)
 <i>Aktivitetet financuese</i>	
Emetimi i aksioneve (1,800 + 200)	2,000
Pagesa e notes kreditore (800 + 40)	(840)
Dividenda e paguar (2,620 + 560 - 2,880)	<u>(300)</u>
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese	860
 Zvogëlimi në para dhe ekuivalentë të parasë gjatë vitit	(520)
 Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 1 janar 2019	100
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 dhjetor 2019	(420)

Llogaritjet

	€'000
<i>Prona, fabrika dhe paisjet</i>	
Saldo me 1 janar 2019	3,720
Rritja në tepricën e rivlerësimit	200
Minus zhvlerësimi	(560)
Minus shitja	(480)
Minus saldo me 31 dhjetor 2019	<u>(5,680)</u>
Para e paguar për blerje të PFP	(2,800)

Tatimi

Saldo me 1 janar 2019 (60 + 100)	160
Plus ngarkesa ne PFH	320
Minus saldo me 31 dhjetor 2019 (100 + 300)	<u>(400)</u>
Tatimi i paguar	80

5.

(a) SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët* është publikuar në vitin 2014 për të zëvendësuar SNK 11 *Kontratat e ndërtimit* dhe SNK 18 *Të hyrat* lidhur me kontabilitetin e njohjes së të hyrave.

Kërkohet:

Shpjego se si SNRF 15 pritet të përmirësoj raportimin e të hyrave në pasqyrat financiare.
(5 pikë)

(b) Titania sh.a përgatit pasqyrat e saj financiare me 31 dhjetor çdo vit. Gjate vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2019, Titania sh.a hyri në transaksionet në vijim:

Me 1 dhejtor 2019, Titania sh.a shiti një makineri tek një klient dhe u pajtuan qe makineria do të këtë servisim pa pagesë deri me 29 shkurt 2022. Total shuma e pagueshme nga klienti për këtë marrëveshje ishte kështu:

- (i) €560,000 nëse klienti paguan para 31 mars 2020.
- (ii) €567,000, nëse klienti paguan para 30 prill 2020.
- (iii) €574,000, nëse klienti paguan para 31 maj 2020.

Drejtorët e Titania sh.a konsiderojnë që ka shumë gjasa që klienti do të paguaj për makinërinë në prill 2020. Çmimi individual i shitjes së makinërisë ishte €490,000 dhe Titania sh.a zakonisht pret të pranoj një konsideratë prej €98,000 servisim të makinërisë përgjatë po të njejtës periudhë. Shumat alternative duhet të konsiderohen si konsideratë variabile.

Kërkohet:

Llogariti shumat e të hyrave që duhet të njihen lidhur me transaksionet mësipër në pajtim me SNRF 15.
(15 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

(a)

SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me klientët është publikuar në maj 2014. Është rezultat i një projekti të përbashkët ndërmjet IASB-së dhe FASB-së për njohjen e të hyrave.

BSNK/IASB publikoi SNRF 15 sepse kriteret ekzistuese për njohjen e të hyrave të kerkuara në SNK 11 dhe SNK 18 u konsideruan shumë subjektive. Andaj ishte e vështirë të verifikohet saktësia e shifrave të raportuara për njohjen e të hyrave dhe kostove të ndërlidhura me to.

Parimi kryesor është që të hyrat njihen për të përshkruar transferin e mallrave dhe shërbimeve tek një klient për një shumë që reflekton konsideratën për të cilën entiteti pret ta fitoj të drejtën në këmbim të mallrave dhe shërbimeve.

Një nga karakteristikat kualitative themelore e informatës financiare të dobishme të cilës i referohet Korniza Konceptuale e BSNK/IASB-së është prezentimi besnik. Informata duhet të jetë e verifikueshme më qëllim që të siguroj përmbushjen e kësaj karakteristike themelore. SNRF 15 jep një kornizë më të fuqishme mbi të cilën mund të mbeshtetet vendimi për njohjen e të hyrave duke rritur kështu verifikueshmërinë dhe dobishmërinë e shifres së raportuar të të hyrave.

(b) Titania sh.a ka dy obligime për performancë: të furnizoj makinërinë dhe të japë shërbim të servisimit.

Total çmimi i transaksionit përbëhet nga një element fiks prej €560,000 dhe një element variabil prej €7,000 ose €14,000.

Elementi variabil duhet të përfshihet në çmimin e transaksionit duke u bazuar në probabilitetin e ndodhjes së tij. Andaj një element variabil prej €7,000 duhet të përfshihet dhe total çmimi i transaksionit do të jetë €567,000.

Çmimi i transaksionit duhet të alokohet tek obligimet për performancë duke u bazuar në vlerat e drejta individuale të tyre. Në këtë rast janë €490,000: €98,000 ose 5:1.

Andaj €472,500 ($€567,000 \times 5/6$) duhet t'i alokohet obligimit për të furnizuar makinerinë dhe €94,500 ($€567,000 \times 1/6$) obligimit për të servisuar makinerinë për dy vite e tre muaj.

Obligimi për të furnizuar makinerinë është përmbushur plotësisht në fund të vitit që përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe të hyrat prej €472,500 lidhur me këtë furnizim duhet të njihen.

Vetëm 1/27 e obligimit për servisim është përmbushur me 31 dhjetor 2019 dhe të hyrat prej €3,500 ($€94,500 \times 1/27$) lidhur me këtë servisim gjithahstu duhet të njihen.

Me 31 dhjetor 2019, Titania sh.a do të njoh një të arkëtueshme prej €567,000 bazuar në çmimin e pritur të transaksionit. Kjo do të raportohet si pasuri qarkulluese.